

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**  
**NDERMARRJA E SHERBIMEVE PUBLIKE, KORCE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Date 01.12.2020

Për: *Shqerine, “REJ” SHPK me NIPT J93711608Q adresa : Tirane Tirane TIRANE Zogu i Zi, Qatar Center, kati 2.*

Procedura e prokurimit: **“Sherbimi i mirembajtjes per njesie administrative Lekas”**

Numri i referencës së procedurës/loti : **REF-76652-10-26-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *Kjo kontrate ka per qellim realizimin e sherbimit dhe mirembajtjen per njesie administrative Lekas.*

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*):

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët per njesi

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

**1. Shoqeria “SARK” SHPK, NIPT K52531415H me vleren:**

**256 (dyqind e pesedhjete e gjashte) leke.**

**2. Shoqerite BOE “I.D.K - KONSTRUKSION” SHPK, NIPT K51408016J dhe “NIEM” SHPK, NIPT K36609610Q me vleren:**

**307 (treqind e shtate) leke.**

**3. Shoqeria “MILENIUM” SHPK, NIPT K04005052C me vleren:**

**756 (shtateqind e pesedhjete e gjashte) leke.**

**4. Shoqeria “REJ” SHPK, NIPT J93711608Q me vleren:**

**1,505.7 (nje mije e peseqind e pese pike shtate) leke.**

**5. Shoqeria “NIKA” SHPK, NIPT J76705047U me vleren:**

**1,605.9 (nje mije e gjashteqind e pese pike nente) leke.**

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

### **1 .Shoqeria “SARK” SHPK, per arsye se:**

Per mjetet e paraqitura ne tender, kamioncinen me targe AA644TO dhe Kamionin me targe FR3215D nuk jane paraqitur dokumentet e pronesise te cilat jane kerkuar shprehimisht ne dokumentet e tenderit, tek kriteret e vecanta te kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 5 ku kerkohet: per mjetet qe shenohen ne regjistra publike (me goma) duhet te paraqitet: *“dokumenti qe verteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikaten e pronesise, certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit”*.

Nga shqyrtimi i ofertes ekonomike te kesaj shoqerie per gabime aritmetikore, rezultoi se oferta ishte e rregullt dhe nuk kishte gabime aritmetike.

Nga verifikimi i bere ne Regjistrin elektronik te gjendjes gjyqesore per personat e deklaruar rezultuan te pa denuar.

### **2 . Shoqerite BOE “I.D.K - KONSTRUKSION” dhe “NIEMI” SHPK per arsye se:**

Nga ana e BOE IDK KONSTRUKSION sh.p.k dhe NIEM sh.p.k eshte paraqitur marreveshje bashkepunimi sipas se ciles shoqeria I.D.K KONSTRUKSION merr persiper kryerjen e 97 % te sherbimeve kurse shoqeria NIEM merr persiper te kryeje 3% te sherbimeve. Referuar akt marreveshjes noteriale te paraqitur ne tender si dhe parashikimeve te VKM per miratimin e rregullave te prokurimit publik ne fuqi neni 74, anetaret e bashkimit duhet te plotesojne kerkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

Për sa me siper oferta juaj nuk ploteson kriteret profesionale dhe teknike si me poshte:

Shoqeria IDK KONSTRUKSION nuk disponon licensen NP-12 per punime te inxhinierise se mjedisit, kerkuar ne dokumentet standarte te tenderit, kriteret e vecanta te kualifikimit, kapaciteti teknik.

Shoqeria IDK KONSTRUKSION nuk disponon mjaftueshem mjetet e nevojshme per te kryer 97% te punimeve te parashikuara ne marreveshje pasi nuk disponon mjetin fadrome te kerkuar ne dokumentet standarte te tenderit, kapaciteti teknik.

Nga shqyrtimi i ofertes ekonomike te ketyre shoqerive per gabime aritmetikore, rezultoi se oferta ishte e rregullt dhe nuk kishte gabime aritmetike.

Nga verifikimi i bere ne Regjistrin elektronik te gjendjes gjyqesore per personat e deklaruar rezultuan te pa denuar.

### **3 .Shoqeria “MILENIUM” SHPK, per arsye se:**

Operatori nuk ploteson kriteret e vecanta te kualifikimit, kapaciteti teknik, sherbime te ngjashme ne vleren 40 % te fondit limit te realizuara gjate 3 viteve te fundit . Nga ana e operatorit eshte paraqitur nje kontrate si

dhe disa fatura tatimore vlere total e te cilave shkon 1906330 leke pa TVSH, vlere e cila nuk kap 40% te fondit limit te realizuara gjate 3 viteve te fundit apo vleren 2047564 leke.

Operatori ekonomik nuk ploteson kriteret e vecanta te kualifikimit, kapaciteti teknik pika 2 ku kerkohet license e kategorise NP-12 A. Operatori ekonomik nuk disponon licensen e kerkuar per punime te inxhinierise se mjedisit apo licensen NP-12 A.

Operatori nuk ka paraqitur dokumente qe vertetojne punesimin e te pakten 6 personave per periudhen korrik 2020 deri shtator 2020 fakt i cili vertetohet me vertetimin e pageses se sigurimeve shoqerore dhe shendetsore te leshuar nga administrate tatimore.

Operatori ekonomik per punonjesin Edmond Branko me detyre shofer nuk ka paraqitur certifikaten e aftesise profesionale. Sipas dokumenteve te tenderit, tek kriteret e vecanta te kualifikimit , kapaciteti teknik kerkohet se per punonjesin shofer duhet te paraqitet kontrata e punes, leja e drejtimit (patenta) dhe certifikata e aftesise profesionale.

Per mjetin e paraqitur ne tender FADROME JCB 3CX nuk jane paraqitur dokumentet e kerkuara kerkuar shprehimisht ne dokumentet e tenderit tek kriteret e vecanta te kualifikimit, kapaciteti teknik, ku shprehimisht per mjetet ne pronesi duhet te paraqitet: leja e qarkullimit, certifikaten e pronesise, certifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni i mjetit”.

Nga shqyrtimi i ofertes ekonomike te ketyre shoqerive per gabime aritmetikore, rezultoi se oferta ishte e rregullt dhe nuk kishte gabime aritmetike.

Nga verifikimi i bere ne Regjistrin elektronik te gjendjes gjyqesore per personat e deklaruar rezultoi se administratori i shoqerise Z. Rustem Bylykbashi rezultoi i denuar.

Me shkresen nr. 960 prot. te dates 16.11.2020 Autoriteti Kontraktor i kerkon Ministrise se Drejtesise Informacion per llojin e vepres penale te Z. Rustem Bylykbashi. Duke qene se informacioni i kerkuar nuk eshte paraqitur per me shume se 1 jave, duke patur si qellim kryerjen e vleresimit brenda afateve ligjore te parashikuar ne ligjin per prokurimin publik, si dhe duke qene se pozita juridike e operatorit ekonomik edhe pasi te paraqitet informacioni i kerkuar nga Ministria e Drejtesise nuk do te ndryshoje ne kete procedure, komisioni vendosi te vazhdoje me procesin e vleresimit.

#### **4 .Shoqeria “NIKA”SHPK, per arsye se:**

Per mjetin e paraqitur ne tender FADROME me targe AA673MO nuk eshte paraqitur dokument pronesie. Nga ana e operatorit ekonomik eshte paraqitur nje kontrate qeraje per marrjen me qira te mjetit dhe dokumentet: leje qarkullimi, certifikate kontrolli teknik dhe siguracion por jo certificate pronesie, e cila eshte kerkuar shprehimisht ne dokumentet e tenderit tek kriteret e vecanta te kualifikimit, kapaciteti teknik, ku shprehimisht per mjetet me qira duhet te paraqitet: *“kontrata e qerases e vlefshme per te gjitha periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi, e shoqeruar me lejen e qarkullimit, certifikaten e pronesise, certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit”*.

Nga shqyrtimi i ofertes ekonomike te ketyre shoqerive per gabime aritmetikore, rezultoi se oferta ishte e rregullt dhe nuk kishte gabime aritmetike.

Nga verifikimi i bere ne Regjistrin elektronik te gjendjes gjyqesore per personat e deklaruar rezultuan te pa denuar.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqerine “**REJ**” SHPK se oferta e paraqitur, me cmim per njesi me vlere prej **1,505.7 leke (nje mije e peseqind e pese pike shtate) leke pa Tvsh** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Ndermarrjes se Sherbimeve Publike, Bashkise Korçë** sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të së këtij njoftimi, por jo me vone se 5 dite nga kerkesa per lidhjen e kontrates.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të veprohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

*Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë : **23.11.2020***

Ankesa: **Nuk ka**

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR  
ILIRJAN DINELLARI**